



[Date]

I nderuar anëtar i NYC Care,

Ju gëzoni akses në një sërë shërbimet shëndetësore për t'ju ndihmuar të qëndroni të shëndetshëm, sidomos gjatë pandemisë së COVID-19, dhe pavarësisht statusit tuaj të imigrimit apo mundësisë për të paguar.

Në këtë buletin informues për anëtarët e **My NYC Care**, ju do të merrni informacione të rëndësishme për:

- + **Shërbimet e anëtarësisë**
- + **Këshilla për jetesë të shëndetshme**
- + **Si të aksesoni testet dhe vaksinat kundër COVID-19**
- + **Histori të anëtarëve të tjerë të NYC Care**

Ekipet tuaja shëndetësore në NYC Health + Hospitals janë të përkushtuara ndaj shëndetit dhe mirëqenies suaj dhe ne e vlerësojmë konfidencialitetin e pacientëve. Për NYC Care mund të regjistrohen të gjithë njujorkezët pavarësisht statusit të imigrimit apo mundësisë për të paguar. Informacioni juaj do të ruhet gjithnjë privat kur të regjistroheni apo rinovoni anëtarësinë.

Nëse keni pyetje, na telefononi te **646-NYC-CARE (646-692-2273)** ose vizitoni faqen tonë të internetit në **www.nyccare.nyc** për të mësuar më shumë.

Faleminderit që na besoni me kujdesin tuaj.

Marielle Kress

Executive Director
NYC Care
NYC Health + Hospitals

Albanian



MY NYC CARE

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

**NYC
CARE**
Your Key
to the City's
Health Care

E DREJTA JUAJ PËR KUJDES SHËNDETËSOR Çfarë mund të bëni për të luftuar COVID-19

Vaksinohuni!

Vaksina e COVID-19 është e sigurt, falas dhe e lehtë. Është mënyra më e mirë për t'ju mbrojtur kundër virusit vdekjeprurës. Të gjithë njujorkezët 12 vjeç apo më të rritur kanë të drejtën për vaksinë dhe shëtitje dhe takime janë në dispozicion në zona të ndryshme në të gjithë qytetin. Ne i nxitim fuqishëm të gjithë anëtarët e NYC Care që të bëjnë vaksinën e tyre sot!

Dy javë pasi të jeni vaksinuar krejtësisht, nuk keni më nevojë të mbani mbulesë për fytyrën ose të qëndroni 6 këmvë larg nga të tjerët në shumë vende. Megjithatë, duhet të vijoni të ndërmerrni këta hapa parandalues:

- + **Qëndroni në shtëpi nëse jeni të sëmurë**
- + **Lajini duart shpesh**
- + **Vini një maskë në hapësirat e mbyllura publike, si për shembull, institucionet mjekësore dhe transportin publik**



Për të mësuar më shumë dhe për të gjetur një pikë vaksinimi, vizitoni nychealthandhospitals.org/covidvaccine.

Dhe mos harroni, mund të kryeni një test falas, të sigurt dhe konfidencial të COVID-19 në pikat anembanë qytetit. Vizitoni nyc.gov/covidtest ose telefononi 212-COVID19 (212-268-4319) për të gjetur një pranë jush.

Vaksina kundër COVID-19 është e sigurt dhe funksionon mirë

Secila prej vaksinave kundër COVID-19 që shpërndahet aktualisht në SHBA ka kaluar provat klinike me pjesëmarrjen e dhjetëra mijëra njerëzve dhe shqyrtimet e sigurisë pranë Agjencisë së Ushqimeve dhe të Barnave të SHBA-së (Food and Drug Administration, FDA) i kanë lejuar për përdorim. Këto vaksina funksionojnë të gjitha shumë mirë kundër sëmundjeve të rënda dhe vdekjes për shkak të COVID-19.

646-NYC-CARE (646-692-2273) • WWW.NYCCARE.NYC




Ashtu si me vaksinat e tjera, vaksina kundër COVID-19 mund të shkaktojë efekte të lehta anësore. Këto efekte anësore janë shenja se trupi juaj po krijon mbrojtjen kundër COVID-19. Për të mësuar më shumë se çfarë duhet të dini përpara dhe pasi të kryeni vaksinën kundër COVID-19, vizitoni nychealthandhospitals.org/covidvaccine.



Kujdesi virtual – Në çdo kohë dhe vend

Teksa vazhdojmë të përballemi me sfidën e pandemisë së COVID-19, shëndeti juaj është më i rëndësishëm se kurrë për ne. Së bashku me takimet në person, anëtarët e NYC Care kanë akses në vizitat me telefon dhe video. Lidhuni me ofruesit tanë shëndetësorë pa qenë nevoja të vini në klinikën e mjekut! Mos e vononi kontrollin! Telefononi në nr. **646-NYC-CARE** dhe lëreni takimin tuaj që sot!

NYC Care ka mbi 50 000 anëtarë!



- + **60 PËR QIND** jetojnë në një lagje të goditur më rëndë nga COVID-19
- + Mbi **50 PËR QIND** janë të rinj në kujdesin shëndetësor primar të NYC Health + Hospitals
- + Anëtarët kanë marrë mbi **35 000** depistime të rekomanduara për kancer
- + Mbi **50 PËR QIND** e anëtarëve me diabet dhe tension të lartë kanë kontroll më të mirë të këtyre sëmundjeve afatgjata.

Ju mund të ndihmoni që më shumë njujorkezë të përfitojnë nga kujdesi shëndetësor me dinjitet dhe respekt. Tregojini një shoku apo familjari të telefonojë në nr. **646-692-2273** për t'u regjistruar sot!

PËRDITËSIMET PËR ANËTARËT

Rinovojeni anëtarësinë tuaj në NYC Care çdo vit

Anëtarësia e NYC Care vlen për një vit. Nevojitet reregjistrim i përvitshëm. Kontrolloni kartën tuaj të anëtarësimit për datën tuaj të regjistrimit. Nëse data juaj e përfundimit të anëtarësisë vjen së shpejti apo ka kaluar, telefononi në nr. **646-NYC-CARE** për:

- + Të lënë një takim
- + T'u reregjistruar
- + Të bërë pyetje rreth përfitimeve tuaja si anëtar.

ANËTARËT NË FOKUS

"Përpara se të bëhesha anëtar i NYC Care në nëntor 2019, kisha frikë dhe të kërkoja kujdes shëndetësor për shkak të statusit tim të imigrimit. Kur më zuri COVID-19 vjet, mora guximin të kërkoj ndihmë pranë NYC Health + Hospitals/Bellevue në Manhattan. E dija se si anëtar i NYC Care do të kisha akses të sigurt në të gjithë kujdesin mjekësor që do të më nevojitej për të më shpëtuar jetën. Kalova 21 ditë i intubuar dhe në fund arrita të shërohem për të rrëfyer historinë time."

– Miguel, anëtar 44-vjeçar nga Queens

Dëshironi ta tregoni dhe ju historinë tuaj frymëzuese për përvojat e hasura me NYC Care? Na dërgoni një email te NYCCare@nychhc.org. Ju lutemi, përdorni subjektin "MY STORY" (HISTORIA IME). Tregimi i historisë suaj do të ndihmojë të tjerët të marrin kujdesin shëndetësor që kanë nevojë dhe që meritojnë! Nëse preferoni, mund të qëndroni anonim (nuk do të përdorim emrin tuaj me historinë).

Për pyetje, na dërgoni email te NYCCare@nychhc.org

